VENDIM
Nr.808, datë 4.12.2003

PËR DHËNIEN E LEJEVE TË MANOVRIMIT PËRDORUESVE TË MAKINERIVE TË RËNDA TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe të nenit 6 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personi fizik, që ushtron profesionin e manovruesit të makinerive të rënda të ndërtimit, duhet të jetë i pajisur me leje manovrimi.

2. Ngritjen e komisionit të posaçëm për dhënien e lejeve të manovrimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Përbërja dhe shpërblimi i anëtarëve të këtij komisioni bëhen me urdhër të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

3. Organizimi e funksionimi i komisionit të posaçëm, si dhe kushtet, kriteret e dhënies së lejes së manovrimit, lloji i makinës që e përfiton këtë leje e disiplinimi i përdorimit të këtyre makinerive të përcaktohen në rregulloren që do të hartohet në bashkëpunim me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë, e që do të miratohet nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

4. Kurset teorike e praktike për përgatitjen e manovruesve të makinerive të rënda të ndërtimit të zhvillohen nga subjektet juridike që kanë në përdorim këto makineri, me autorizim të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin këto subjekte juridike do të përcaktohen në rregulloren e përmendur në pikën 2 të këtij vendimi.

6. Përdorimi i makinerive të rënda pa lejen e manovrimit përbën dhe ndëshkohet si shkelje e rregullave të sigurimit teknik në ndërtim.

7. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano